

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

SEKTORI I RRUGËVE RURALE DHE BORDIT TË KULLIMIT



Lënda: Informacion nga Sektori i Rrugëve Rurale mbi gjendjen e rrugëve të fshatrave dhe masat e marra për sezonin e dimrit.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Sektori i Rrugëve Rurale si cdo vit ka kryer mirëmbajtjet e zakonshme në rrugët e zonave rurale. Më poshtë do të gjeni një informacion mbi rrugët dhe fshatrat në të cilët është ndërhyrë për sistemimin apo mirëmbajtjen e rrugëve.

Njësia Administrative Çarçovë:

Është ndërhyrë në të gjithë fshatrat e kësaj njësie.

- Rruga në fshatin Iljarë e Vjetër, është shpërndarë çakëll
- Rruga në fshatrat Kanikol dhe Draçovë
- Rruga në fshatin Kanikol – Zhepë, është shpërndarë çakëll
- Rruga në fshatrat Biovizhë dhe Vllahpsilloterë
- Rruga në fshatin Stërmbec

Njësia Administrative Petran

Është ndërhyrë në rrugët e fshatrave:

- Lëshicë, skarifikim
- ZBU-Badëlonjë, është shpërndarë çakëll
- Qilarisht i Vjetër, është shpërndarë çakëll
- Badëlonjë-Gjinkar-Petran i Vjetër, është shpërndarë çakëll
- Ogdunan, skarifikim i rrugës

Njësia Administrative Piskovë

Është ndërhyrë në rrugët e fshatrave:

- Buhal, skarifikim dhe është shpërndarë çakëll
- Grabovë, skarifikim dhe është shpërndarë çakëll
- Zyrat e Kuqarit, është shpërndarë çakëll
- Pacomit, është shpërndarë çakëll
- Rapckë, skarifikim dhe është shpërndarë çakëll

- Odriçan, skarifikim dhe është shpërndarë çakëll
- Pagri, është shpërndarë çakëll
- Mokricë, Zleushë, Hotovë dhe Raban, skarifikim i rrugëve

Perveç sa më sipër, ky sektor ka kryer dhe punime të tjera për mirëmbajtjet e rrugëve me anë të punonjësve si, pastrim nga shkuret dhe mbetje të tjera sidomos ne rrugën që të çon në Banjat e Bonjës, akset nacionale (pjesë e aksioneve të pastrimit), etj.

Për shkak të pamundësisë për të patur të gjithë flotën e mjeteve në funksion për një periudhë 1 mujore si rezultat i defekteve të rënda që kanë patur dy nga mjetet, fadroma JCB riparim i motorit dhe kamioni MAN riparim i kamios, defekte të cilët nuk mund të kryheshin nga ana e mekanikeve ne bashki, ka mbetur pa u kryer mirëmbajtja e zakonshme për fshatrat:

- Kosovë
- Tremisht
- Bejkollarë

Si dhe në Njësinë Administrative Frashër, nuk është ndërhyrë.

Gjithsesi po shikohet mundësia për ndërhyrje në këto fshatra sidomos në pikat më problematike dhe që mund të krijojnë bllokim të akseve rrugore.

Panvarsisht problematikave të mësipërme të gjitha rrugët në të gjithë zonën rurale të bashkisë janë të kalueshme. Dhe pas situatës së shirave që kanë rrënë ditët e fundit, gjendja e rrugëve është e mirë dhe e kalueshme. Problematika të vogëla ka patur në rrugën e Frashërit dhe atë që të çon në fshatin Miçan të cilat janë zgjidhur në kohë.

Megjithë punët e kryera nga Sektori i Rrugëve Rurale, rrjeti rrugor rural në bashkinë Përmet mbetet problematik. Duke qënë se pjesa më e madhe e rrugëve janë të paasfaltuara dhe në reliev të thyer, për çdo sezon vjeshtë-dimër shfaqen probleme të cilat janë zgjidhur në kohë.

Pëesa i përket stinës së dimrit janë marrë të gjitha masat e nevojshme si për gadishmërinë e mjeteve, punonjësit dhe bazës materiale, për të zgjidhur çdo problematikë apo emergjencë që mund të lind.

Ju faleminderit!

NËNKRYETAR I BASHKISË

Florand HASANI

